

PROKURIMI I GJELBËR PUBLIK

1. Si filloi gjithçka — baza ligjore

Shqipëria e përfshiu konceptin e prokurimit të gjelbër publik në kuadrin e saj ligjor me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i cili është i harmonizuar me direktivat kryesore të BE-së në fushën e prokurimit. Ky ligj u dha institucioneve shtetërore të drejtën dhe mjetet ligjore për të blerë mallra, shërbime dhe punime duke marrë parasysh kriteret mjedisore, jo vetëm çmimin. Konkretisht, ligji parashikon mundësinë e përdorimit të ofertës ekonomike më të favorshme (MEAT), të kostimit të ciklit të jetës (LCC) dhe të etiketave mjedisore si kriter vlerësimi. Megjithatë, ligji e trajton prokurimin e gjelbër si instrument vullnetar, çdo institucion vendos vetë nëse e zbaton.

2. Organizata zbatuese dhe dokumentet udhëzuese

Institucioni përgjegjës për zbatimin dhe promovimin e prokurimit të gjelbër është Agjencia e Prokurimit Publik (APP), e cila funksionon nën Këshillin e Ministrave. APP është edhe institucioni kryesor që koordinon negociatat me BE-në në fushën e prokurimit publik.

Në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me mbështetjen e qeverisë zvicerane, APP ka publikuar dy dokumente themelore: Udhërrëfyesin për zbatimin e prokurimit të gjelbër publik dhe Metodologjinë udhëzuese për zbatimin e prokurimit të gjelbër publik, të dyja të vitit 2024.

Çfarë thotë Udhërrëfyesi

Udhërrëfyesi shpjegon se si aplikohen kriteret mjedisore në çdo fazë të procesit të prokurimit, nga studimi paraprak i tregut, tek hartimi i specifikimeve teknike, tek vlerësimi i ofertave dhe deri tek klauzolat e kontratës. Ai i drejton institucionet të përdorin standardet dhe etiketat mjedisore të njohura në Shqipëri dhe në BE, dhe thekson se prokurimi i gjelbër nuk duhet të shërbejë kurrë për të kufizuar konkurrencën ose për të favorizuar furnizues të caktuar.

Çfarë thotë Metodologjia

Metodologjia është dokumenti teknik zbatues. Ajo përcakton 20 kategori konkrete produktesh dhe shërbimesh ku mund të aplikohet prokurimi i gjelbër, dhe për secilën kategori ofron shembuj specifikimesh teknike, kriteresh vlerësimi dhe metodash llogaritjeje të kostos së ciklit të jetës. Është dokumenti që një specialist prokurimi hap kur dëshiron të hartojë konkretisht një tender të gjelbër.

3. 20 Kategoritë e prokurimit të gjelbër

Metodologjia mbulon 20 kategori produktesh dhe shërbimesh ku mund të vendosen kritere mjedisore:

- 1. Pajisje IT për zyra
- 2. Letër fotokopjuese dhe grafike
- 3. Shërbime të ushqimit dhe kateringut
- 4. Transport rrugor: (a) vetura; (b) autobuza; (c) shërbimet e autobusëve
- 5. Infrastrukturë rrugore
- 6. Pajisje të imazheve, materiale të konsumueshme dhe shërbime printimi
- 7. Qendra të të dhënave, dhoma të serverëve dhe shërbime cloud
- 8. Mirëmbajtje e hapësirave publike
- 9. Ndriçim rrugor dhe sinjalistikë e trafikut
- 10. Shërbime të pastrimit të ambienteve të brendshme
- 11. Produktet dhe shërbime të tekstilit
- 12. Mobilje
- 13. Rubineta sanitare
- 14. Tualete me shkarkim dhe urinale
- 15. Bojra, verniqe dhe vijëzime të rrugëve
- 16. Pajisje për ngrohje me ujë
- 17. Infrastruktura e Ujërave të Ndotura
- 18. Projektim, ndërtim dhe menaxhim i ndërtesave të zyrave
- 19. Energji elektrike
- 20. Pajisje elektrike dhe elektronike në sektorin e kujdesit shëndetësor

4. Çfarë synon të arrijë Prokurimi i Gjelbër

Prokurimi i Gjelbër synon që paratë publike të përdoren për të blerë produkte, shërbime dhe investime që janë më të qëndrueshme, më efikase dhe me ndikim më të ulët në mjedis.

- a) **Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm** - Të ulë ndikimin negativ të produkteve, shërbimeve dhe investimeve publike në mjedis.

Dokumenti e vendos këtë si objektivin kryesor të Prokurimit të Gjellbër. Ideja është që shteti, kur blen produkte ose financon punime publike, të marrë parasysh ndikimin që ato do të kenë në mjedis. Pra, mjedisi nuk konsiderohet më një çështje e veçuar nga prokurimi, por një element që hyn në vetë procesin e vendimmarrjes.

- b) **Përdorimi efikas i energjisë dhe burimeve** - Të favorizojë produkte dhe zgjidhje që konsumojnë më pak energji dhe përdorin më mirë burimet natyrore.

Udhërrëfyesi kërkon që institucionet të favorizojnë produkte dhe shërbime që përdorin më pak energji dhe më pak burime gjatë përdorimit të tyre. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e mjedisit, por edhe me shmangien e kostove të panevojshme gjatë viteve të përdorimit të një produkti apo infrastrukture.

- c) **Nxitja e teknologjive të gjelbra** - Të mbështesë zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive më miqësore me mjedisin dhe të krijojë treg për to.

Një nga synimet është të krijohet kërkesë për produkte dhe teknologji më miqësore me mjedisin. Kur institucionet publike fillojnë t'i kërkojnë këto produkte në tendera, ato krijojnë treg për alternativa më të pastra dhe inkurajojnë zhvillimin e teknologjive të gjelbra.

- d) **Përdorimi më i mirë i fondeve publike** - Të inkurajojë blerjen e produkteve dhe shërbimeve më jetëgjata, që kushtojnë më pak gjatë përdorimit dhe kanë ndikim më të ulët në mjedis.

Dokumenti nuk e sheh prokurimin e gjellbër si një shpenzim shtesë. Përkundrazi, ai argumenton se blerja e produkteve më jetëgjata dhe më efikase mund të sjellë përdorim më të mirë të fondeve publike. Qëllimi është të mos blihet vetëm më lirë në momentin e tenderit, por të merren në konsideratë kostot dhe përfitimet gjatë gjithë jetës së produktit.

- e) **Përmirësimi i cilësisë së jetës** - Të promovojë sjellje më të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe të kontribuojë në mirëqenien e qytetarëve përmes investimeve publike.

Udhërrëfyesi lidh drejtpërdrejt prokurimin e gjellbër me qytetarin. Ai parashikon që përmes investimeve publike të promovohen sjellje më të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe të krijohen kushte më të mira jetese. Kjo është arsyeja pse dokumenti e konsideron Prokurimin e Gjellbër jo vetëm si një instrument administrativ, por edhe si një mjet me ndikim shoqëror.

5. Përmbledhje e hapave kryesorë të Prokurimit të Gjellbër Publik

NR.	HAPA	ÇFARË BËN	KUR E BËN
1.	Studim tregun	Kontrollo nëse ekzistojnë produkte të gjelbra dhe sa kushtojnë	Para se të fillosh tenderin
2.	Specifikimet teknike	Përcakto standardin mjedisor minimal që duhet të plotësojë produkti	Gjatë hartimit të dokumenteve tenderit
3.	Kriteret e vlerësimit	Jep pikë shtesë për oferta që shkojnë përtej minimumit	Gjatë hartimit të dokumenteve tenderit
4.	Kostimi i ciklit të jetës	Llogarit koston e vërtetë, jo vetëm çmimin e blerjes	Gjatë vlerësimit të ofertave
5.	Klauzolat e kontratës	Fut kushte që garantojnë zbatimin e standardeve mjedisore	Gjatë hartimit të kontratës
6.	Monitorimi	Kontrollo nëse furnizuesi i respekton kushtet mjedisore	Gjatë zbatimit të kontratës

Kostimi i ciklit të jetës është ndoshta një nga idetë më interesante të udhërrëfyesit. Ai sugjeron që institucionet të mos fokusohen vetëm te çmimi i blerjes, por të llogarisin të gjitha kostot që lidhen me produktin: energjinë që konsumon, mirëmbajtjen, pjesët e këmbimit, riparimet, riciklimin apo asgjësimin në fund të përdorimit. Në këtë mënyrë, një produkt që kushton pak më shumë sot mund të rezultojë më ekonomik në afat të gjatë.

6. Lidhja me sektorin RACHP)

Një nga fushat ku prokurimi i gjellbër ka rëndësi të veçantë për Shqipërinë është sektori i pajisjeve të ftohjes, kondicionimit të ajrit dhe pompave të Nxehtësisë, RACHP. Kjo për një arsye shumë konkrete: Shqipëria ka ratifikuar Amendamentin Kigali të Protokollit të Montrealit në vitin 2019, duke u zotuar të reduktojë dhe eliminojë gradualisht përdorimin e hidrofluorokarboneve (HFC) — gazet ftohëse që përdoren gjerësisht në kondicionerë, frigoriferë, sisteme ftohëse industriale dhe që kanë ndikim shumë të lartë në ngrohjen globale.

Sektori publik është konsumatori më i madh në vend i këtyre pajisjeve. Ministritë, shkollat, spitalet, burgjet, shtëpitë e të moshuarve, të gjitha kanë sisteme kondicionimi dhe ftohëse. Kur shteti blen pajisje të reja, ka mundësinë të zgjedhë pajisje me gaz ftohës alternativ me ndikim të ulët klimatik. Kjo ndikon drejtpërdrejt në uljen e volumit të HFC-ve në vend, por ka edhe një efekt tjetër të rëndësishëm: duke qenë blerësi më i madh në treg, shteti mund të shtyjë të gjithë tregun privat drejt teknologjive më të pastra.

7. Çfarë do të thotë kjo për kompanitë furnizuese

Kur shteti vendos të blejë me kritere mjedisore, kjo nuk ndikon vetëm tek institucioni blerës, ndikon drejtpërdrejt tek çdo kompani që dëshiron të furnizojë atë institucion. Një tender i gjelbër do të thotë se oferta juaj vlerësohet jo vetëm me çmim, por edhe me atë çfarë produkti ofron: sa energji harxhon, çfarë gazi përdor, çfarë emetimesh prodhon gjatë gjithë jetës së tij. Nëse produkti nuk plotëson standardin minimal të kërkuar, oferta mund të skualifikohet, pavarësisht çmimit.

Nga 20 kategoritë e metodologjisë, pajisjet RAC/RACHP shfaqen në disa prej tyre njëkohësisht. Kur shteti blen autobuza ose automjete publike, kërkohet që sistemet e kondicionimit të ajrit të përdorin ftohës natyralë — jo HFC. Kur blen ose renovon ndërtesa zyresh, kërkohet Certifikatë Performanse Energjetike të paktën e klasit C, që do të thotë se sistemi HVAC i të gjithë ndërtesës duhet të plotësojë standarde të larta. Kur blen pompa nxehtësie, vendosen kufij konkretë emetimesh: çdo rrjedhje e gazit ftohës llogaritet si emetim dhe ndikon në vlerësimin e ofertës. Kur blen pajisje për spitale ose qendra shëndetësore, kërkesat e eficiencës energjetike përfshijnë edhe sistemet frigoriferike dhe të kondicionimit.

Mesazhi është i thjeshtë: tregu publik po ndryshon rregullat e lojës. Kompanitë që tashmë ofrojnë produkte me gaze alternative, me certifikime të njohura dhe me dokumentacion teknik të gatshëm do të fitojnë akses në tenderë ku të tjerët nuk do të kualifikohen fare.

8. Si do të dukej konkretisht një prokurim i gjelbër RAC

Le të marrim shembullin e një shkolle që dëshiron të blejë kondicionerë të rinj. Nën kuadrin e prokurimit të gjelbër, procesi do të ndryshonte si më poshtë.

Fillimisht, para hapjes së tenderit, institucioni do të bënte një studim të shkurtër të tregut për të kontrolluar cilat pajisje me gaz ftohës alternativ — si R-

32 ose R-290, me GEP të ulët — janë të disponueshme te furnizuesit shqiptarë dhe me çfarë çmimi.

Pastaj, në specifikimet teknike të tenderit, do të shënohej jo vetëm fuqia e kondicionerit, por edhe dy kushte mjedisore: klasa energjetike minimale A++ dhe gazi ftohës me GEP nën 150. Çdo ofertë që nuk i plotëson këto dy kushte do të skualifikohej automatikisht.

Gjatë vlerësimit të ofertave, institucioni nuk do të shikonte vetëm çmimin e blerjes. Do të llogariste koston e vërtetë gjatë 10 viteve: çmimi fillestar plus faturat e energjisë elektrike, mirëmbajtja dhe kostoja e asgjësimit në fund. Kjo metodë quhet kostimi i ciklit të jetës dhe shpesh tregon se një kondicionier "i lirë" që harxhon shumë energji del shumë më i shtrenjtë sesa një i shtrenjtë me efikasitet të lartë energjetik.

Së fundi, në kontratën me furnizuesin do të futeshin kushte konkrete: furnizuesi garanton klasën energjetike të deklaruar dhe, nëse pajisja nuk e arrin atë nivel në praktikë, zbatohet penalteti.

9. Ku jemi sot

Pavarësisht kuadrit ligjor dhe dokumenteve udhëzuese të hartuara, deri në vitin 2025 në Shqipëri nuk është raportuar asnjë procedurë prokurimi publik e gjelbër. Çmimi vazhdon të jetë kriteri i vetëm dominant në të gjitha blerjet publike, duke përfshirë edhe blerjet e pajisjeve RAC. Asnjë institucion nuk ka aplikuar kosto të ciklit të jetës, asnjë tender nuk ka kërkuar etiketë mjedisore, dhe asnjë kontratë nuk ka përfshirë klauzola performance mjedisore.

10. Sfidat kryesore

Arsyet e kësaj gjendjeje janë të shumta dhe të ndërlidhura. Para së gjithash, mungon angazhimi politik i qartë — prokurimi i gjelbër nuk është i detyrueshëm dhe nuk ka asnjë institucion që e kërkon aktivisht. Kapacitetet njerëzore janë të kufizuara: specialistët e prokurimit nuk janë trajnuar për të aplikuar kriteret mjedisore dhe nuk dinë si të llogarisë koston e ciklit të jetës. Mungon gjithashtu buxhetimi i gjelbër — institucionet nuk kanë fonde të dedikuara për të blerë pajisje me çmim fillestar më të lartë, edhe kur ato janë më ekonomike afatgjatë.

Në sektorin RAC/RACHP në veçanti, situata është edhe më e vështirë. Tregu vendas është ende i kufizuar në ofertën e pajisjeve me gaz ftohës alternativ, çmimet e tyre janë më të larta se ato konvencionale dhe nuk

ekzistojnë ende metodologji specifike për llogaritjen e kostos së ciklit të jetës për pajisjet RAC.

11. Detyrimet ndaj BE-së

Konteksti i integritit evropian e bën këtë çështje edhe më urgjente. Strategjia e re e Prokurimit Publik 2024–2030 parashikon që deri në vitin 2027 të paktën 20% e të gjitha procedurave të prokurimit publik të përfshijnë kritere mjedisore. Ky është një tregues kyç që do të matet dhe do të raportohet në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit. Komisioni Evropian ka vërejtur tashmë progres të kufizuar të Shqipërisë në fushën e axhendës së gjelbër dhe ka kërkuar forcim të përpjekjeve. Mospërmbushja e këtij objektiv do të ndikojë drejtpërdrejt në vlerësimin e Shqipërisë në kapitujt e negociatave që lidhen me mjedisin dhe prokurimin publik.

12. Çfarë duhet të mbajë mend një drejtues institucioni?

- Vendimi për të zbatuar PPGj nuk është i detyrueshëm deri tani.
- Kur e zbaton, duhen respektuar të njëjtat parime si në çdo prokurim tjetër: transparencë, konkurrencë e lirë, trajtim i barabartë i ofertuesve.
- PPGj **nuk është arsye** për të favorizuar një furnizues të caktuar.
- Metodologjia e detajuar e APP-së është në dispozicion nëse ke nevojë për shembuj specifike sipas kategorisë së produktit.

13. Ku mund të merret ndihmë?

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) — app.gov.al Ofron metodologjinë e plotë, shembuj praktikë dhe mbështetje teknike.

Njësia Kombëtare e Ozonit (NOU) — ozoneal.com Për çdo pyetje specifike lidhur me pajisjet RACPH (kondicionerë, frigorifer, sisteme ftohëse, pompa nxehtësie) dhe gazet alternativë me ndikim të ulët klimatik.

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen e UNIDO-s përmes projekteve për zbatimin e Amendamentit të Kigalit në Shqipëri.